



MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGININ E ZGJEDHJEVE RIVOTIM NË ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE, ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË, 1 QERSHOR 2008

Rivotimi u zhvillua pa dhunë, por procesi në përgjithësi nuk i plotësoi disa nga obligimet kryesore, thonë vëzhguesit në Shkup.

SHKUP, 16 qershor 2008 – Rivotimi i djeshëm në rajonet ku u shënuan parregullsi të mëdha më 1 qershor paraqiti mundësi për votuesit të shprehin vullnetin e tyre në një ambient të sigurt dhe kryesisht të qetë. Përkundër përpjekjeve të institucioneve shtetërore për të siguruar rivotim të suksesshëm, mbetën raste tensionimesh dhe frikësimesh në periudhën para dhe gjatë 15 qershorit. Përkatësisht, shumë nga personat të cilët paraprakisht kishin kryer shkelje dhe dhunë në lidhje me zgjedhjet mbeten për t'u marrë në përgjegjësi.

Përmirësimi i konsiderueshëm i sigurisë gjatë rivotimit mundësoi që e shumta e njerëzve të votonin lirshëm, por kjo nuk ndryshon vlerësimin se megjithëse zgjedhjet u drejtuan mirë, disa nga obligimet thelbësore të OSBEs dhe KEs nuk u plotësuan gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve parlamentare. Ky vlerësim duhet të shihet në kontekst të Deklaratës të Misionit Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ) nga 2 qershori.

“Zgjedhjet e djeshme treguan përmirësim të ndjeshëm sa i përket çështjeve kryesore që kanë të bëjnë me sigurinë. Shpresoj dhe pres kjo të dëshmoj se vendi është i gatshëm të përballet me disa sfida demokratike që mbeten. Kjo ka rëndësi thelbësore kur bëhet fjalë për dëshirën e vendit të bëhet pjesëmarrës i barabartë me vendet tjera demokratike. Shpresojmë se tani janë kthyer në rrugën e mirëfilltë,” tha Pia Christmas-Møller nënkryetare e AP OSBEs, koordinatorë speciale e vëzhguesve afatshkurtër.

“Në një shoqëri shumëetnike, autoritetet dhe aktorët politikë bartin përgjegjësinë për të siguruar kushte të vërteta që qytetarët të shprehin vullnetin e tyre të lirë mbarë vendit pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Siguria dhe situata kryesisht e qetë gjatë rivotimit, vetëm dy javë pas incidenteve të dhunshme dhe parregullsive zgjedhore, tregojnë qartë se ka pasur mundësi të evitohen ngjarjet e 1 qershorit. PACE, në kuadër të mekanizmave vëzhguese, do të përcjell nga afër zhvillimet e mëtejshme dhe do të mbetet i gatshëm të mbështesë vendin në zhvillimin demokratik të mëtejshëm”, tha Mevlüt Cavuşoğlu, shefi i Delegacionit të APKE.

“Institucionet shtetërore duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për të marrë në përgjegjësi ata që kanë përdorur dhunë dhe kanë kryer shkelje gjatë zgjedhjeve, përfshi këtu edhe shkarkimin e aktivistëve partiak nga funksione të larta në polici. Në të kundërtën, do të vazhdojë kultura e mosndëshkimit që mbizotëron në rajonet me etnike shqiptare dhe do të vazhdojë nevoja për prani të madhe të policisë për të parandaluar ngjarje si ato të 1 qershorit gjatë zgjedhjeve të ardhshme”, tha Ambasadori Robert Barry, Shefi i misionit vëzhgues afatgjatë i OSBE/ODIHR.

Gjatë ditës të rivotimit, prania e policisë në 187 vendvotimet ku u përsëritën zgjedhjet ishte shumë më e madhe se më 1 qershor dhe u tregua efikase në parandalimin e incidenteve të dhunshme. Megjithatë, në disa raste të pakta policia nuk ndërmori masa efikase kundër frikësimeve që bënin aktivistët partiak në dhe rreth vendvotimeve. Megjithëse se hapja dhe votimi u vlerësuan pozitivisht, kishte indice për gabime procedurale dhe shkelje gjatë votimit, nga të cilat duhet theksuar 5 raste të mbushjes të kutive dhe prania e personave të paautorizuar në 24% të vendvotimeve të vizituara. Votimi u anulua në katër vendvotime. Nga 30 vendvotime shtatë u

vlerësuan negativisht dhe falsifikime të qëllimshëm u shënuan në katër raste. Kishte shtypje që të imponohen rezultate të falsifikuara në dy Komisione Komunale Zgjedhore (Tetovë dhe Saraj), por prania e policisë, zyrtarëve të lartë të organeve zgjedhore dhe vëzhguesve ndërkombëtarë parandaluan falsifikimin e mundshëm.

Në konkluzionet preliminare të vëzhguesve ndërkombëtarë më 2 qershor thuhej “vlerësimi i përgjithshëm do të varet nga ajo nëse autoritetet do të zbatojnë hetim të plotë ... shkeljet e rënda të ligjit dhe të marr masa kundër tyre”. Ministria e Brendshme njoftoi se 164 kallëzime penale ishin paraqitur kundër kryerësit e shkeljeve gjatë ditës të votimit por që nga 14 qershori më pak se 25 janë arrestuar si rezultat i këtyre përpjekjeve. Duhet theksuar se asnjë nga këto masa nuk u ndërmor në rajonin e Tetovës, megjithëse ishte komuna ku u anulua numri më i madh i vendvotimeve. Disa nga personat e njëjtë përgjegjës për shkeljet zgjedhore më 1 qershor u vërejtën rreth vendvotimeve edhe më 15 qershor.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KShZ) në mënyrë efektive trajtoi ankesat për ditën e zgjedhjeve të 1 qershorit. Gjatë një procesi të hapur dhe transparent, KShZ shqyrtoi ankesat për dhunë ose parregullsi zgjedhore kundër 376 vendvotimeve, duke analizuar materialin zgjedhor dhe duke bazuar vendimet jo vetëm mbi ankesat e dorëzuara por edhe mbi vëzhgimet e veta. Anëtarët e KShZ vepruan në mënyrë të vendosur duke votuar për të anuluar rezultatet në 197 vendvotime.

Tre nga katër Këshillat e Gjyqit Suprem mbështetën pothuajse të gjitha vendimet e KShZ, dhe shtuan vetëm një vendvotim në listën e rezultateve të anuluar. Këshilli i katërt, megjithatë, rrëzoi 11 vendime të KShZ duke thënë se nuk kishte konstatuar parregullsi – përfshi këtu edhe raste ku dalja në zgjedhje tejkalonte 95% dhe ku vëzhguesit e MNVZ kishin qenë dëshmitarë të parregullsive më 1 qershor.

Me qëllim të marrjes në përgjegjësi për shkeljet në ditën e votimit, KShZ gjithashtu shkarkoi nga detyra 6 kryetarë të Komisioneve komunale të zgjedhjeve në vendet ku ka pasur numër të madh problemesh gjatë ditës të zgjedhjeve. Megjithëse arsytet ishin të mirëfillta, ky hap shkaktoi konfuzion në përgatitjen e rivotimit. Lista e vendvotimeve ku duhej të zhvillohet rivotimi u përfundua më 13 qershor, vetëm dy ditë para votimit.

Liderët e dy partive kryesore shqiptare përdorën retorik të ashpër në fillim të periudhës para votimit, megjithëse tonet u zbutën në prag të zgjedhjeve. Aktivistët ishin tepër të pranishëm rreth vendvotimeve dhe në disa raste sillëshin në mënyrë kërcënuese ndaj zyrtarëve zgjedhorë si dhe ndaj vëzhguesve të vendit dhe të huaj.

Misioni ndërkombëtar për vëzhgimin e zgjedhjeve është një ndërmarrje e përbashkët mes OSBE, Zyra për Institucionet Demokratike dhe të drejtat e njeriut, Asambleja Parlamentare e OSBE dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës. Në ditën e votimit, MNVZ vendosi 39 grupe vëzhguesish dhe mbuloi 160 vendvotime dhe 18 Komisione Komunale të Zgjedhjeve në të cilat zhvillohej rivotimi.

Institucionet e përfaqësuara në MNVZ falënderojnë autoritetet e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për bashkëpunimin e tyre, dhe mbeten të gatshëm të vazhdojnë t’i mbështesin ata dhe shoqërinë civile në vend, në mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. OSBE/ODIHR do të lëshoj raportin përfundimtar, duke përfshirë dhe rekomandime për përmirësime të mundshme, rreth dy muaj pas përfundimit të procesit zgjedhor. AP OSBE të paraqes raportin para Komitetit të Përhershëm në mbledhjen e tij më 29 qershor 2008 dhe PACE do të paraqes raportin e tij në seancën e Qershorit 2008